



**HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A.**  
**BORDI I DREJTORËVE**

Nr. I/120

Datë: 30.09.2025

Bazuar në Nenin 34 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Nenin 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087, si dhe në bazë të Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 27, të mbajtur më 30.09.2025 njëzëri nxori këtë:

**VENDIM**

- I. Miratohet propozimi për rritje të pagës bazë për të gjithë punonjësit e HK-Trainkos Sh.A. në shumën fikse prej 30 (tridhjetë) euro, si dhe pagesa e shujtës ditore në shumën 2.5 (dy pikë pesë) euro për secilën ditë pune të realizuar.
- II. Menaxhmenti i Ndërmarrjes obligohet të bëjë të gjitha përgatitjet e nevojshme administrative dhe financiare për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rritja e pagës bazë prej 30 eurove do të reflektohet edhe në Aneksin 1 të Rregullores për Paga dhe Kompensime të Tjera të HK-Trainkos Sh.A., Nr. I/131, datë 29.08.2024, përkatësisht në Kategoritë dhe Nivelet e Pagave, i cili do t'i bashkëngjitet këtij vendimi si pjesë përbërëse.
- IV. Zbatimi i këtij vendimi fillon nga data 01.10.2025 dhe mbetet në fuqi deri në një vendim të ri të Bordit të Drejtorëve.

**Arsyetim**

Duke marrë parasysh se pagat e punonjësve të HK-Trainkos Sh.A. nuk kanë pësuar rritje për gati pesëmbëdhjetë (15) vite, në një kohë kur çmimet dhe inflacioni janë rritur ndjeshëm, dhe duke marrë në konsideratë kërkesat e përsëritura të punonjësve, si dhe nevojën për të ruajtur dhe motivuar stafin ekzistues, sidomos në sektorët vitalë operacionalë, Bordi i Drejtorëve e vlerëson të domosdoshme ndërmarrjen e këtij hapi për të përmirësuar gjendjen ekonomike të punonjësve dhe për të garantuar funksionalitetin dhe stabilitetin e ndërmarrjes.

Jetmir NUKA – Kryesues



Iu dërgohet:

- NJPMNP

- Kryeshefit Ekzekutiv
- Departamentit të Administratës
- Arkivit